



A është Ajeti Kursij - dhikër i mëngjesit dhe mbrëmjes?

الحمد لله و صلى الله و سلم على نبينا محمد .أما بعد

Ka mospajtim ndërmjet dijetarëve në lidhje me leximin e Ajetit Kursij në mëngjes dhe në mbrëmje.

Disa dijetarë e konsiderojnë leximin e Ajetit Kursij prej dhikre të mëngjesit dhe mbrëmjes.

Ndërsa disa të tjerë nuk e konsiderojnë leximin e Ajetit Kursij prej dhikre të mëngjesit dhe mbrëmjes.

Ata që e konsiderojnë leximin e Ajetit Kursij prej dhikre të mëngjesit dhe mbrëmjes bazohen në disa hadithe të cilat shumica e dijetarëve i konsiderojnë të dobta. Prej tyre, hadithi:

مَنْ قَرَأَ { حم { الْمُؤْمِنَ إِلَى { إِلَيْهِ الْمَصِيرُ } وَآيَةَ الْكُرْسِيِّ حِينَ يُصْبِحُ حَفِظَ بِهِمَا حَتَّى يُمَسِيَ، وَمَنْ قَرَأَهُمَا حِينَ يُمَسِيَ حَفِظَ بِهِمَا حَتَّى يُصْبِحَ ((يُصْبِحُ))

((Kush lexon {HA MIIM} deri te ajeti {ILEJHIL MESIIR}, (dmth: tre ajetet e sures Gafir) dhe ajetin Kursij në mëngjes, mbrohet deri në mbrëmje. Dhe kush i lexon në mbrëmje, mbrohet deri në mëngjes))

Transmeton [Termidhi. 2879]

[Ibn Es-Sunnij - Amelul Jeumi uel Lejleh 76]

[Ebu Nuajm - Teerikh Esbhaan 1/281]

[dorar net]

Shumica e dijetarëve e konsiderojnë këtë hadith të dobët. Prej tyre:

-- Ibn Haxheri në [El Futuhaat Er-Rabbaanijeh 5/108]. Ndërsa në [Hidejetur - Ruwaat.2/376] e konsideron hasen.

-- Es-Sekhauij në [El ibtihaaxh. 14] e konsideron të dobët.

-- Ed-Dimjati në [El Metxher Er-Raabih. 222] e konsideron të dobët.

-- Albani në [Daiif Et Termidhi 2879] e konsideron të dobët. Ndërsa në [Hidejetur Ruwaat 2082] e konsideron shumë të dobët.

Transmetohen edhe hadithe të tjera, por të gjitha janë të dobëta.

Ka disa hadithe të sakta në transmetim që përmendin leximin e Ajetit Kursij.

Në disa rrugë transmetimi përmendet leximi i tij në mëngjes dhe në mbrëmje, si hadithi i Ebu Hurejres - radijall-llahu anhu - që tregon se një xhin vinte të vidhte prej hurmave të sadakasë...

Në një prej transmetimeve të këtij hadithi përmendet se xhinni i tha: *"T'a lexosh Ajetin Kursij në mëngjes dhe në mbrëmje."*

Baza e hadithit është e saktë, e transmeton Buhariu dhe Muslimi, por **shtesa që përmend leximin e tij në mëngjes dhe në mbrëmje është e dobët.**

Prandaj Buhariu dhe Muslimi në Sahihet e tyre kur e transmetojnë këtë hadith të Ebu Hurejres, e transmetojnë pa shtesën "Në mëngjes dhe në mbrëmje".

Po ashtu hadithi i Ubej Bin Keab - radijall-llahu anhu - i cili tregon se një xhin hynte në shtëpinë e tij dhe vidhte nga hurmat e tij. Ubeji pasi e kapi i tha: *ç'farë na mbron nga ju?* Ai tha: *"Ajeti Kursij. Nëse e thua në mëngjes, mbrohesh deri në mbrëmje. E nëse e thua në mbrëmje mbrohesh deri në mëngjes."*

Ubeji i tregoi Profetit për këtë, dhe Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem tha:

((Të vërtetën e ka thënë i poshtri))

Ky hadith është i saktë në gjykimin e disa dijetarëve, prej tyre shejh Albanit, siç thotë në [Sahih Et-Tergib uet Terhib]

Por, shtesa ku përmend "leximin e Ajetit Kursij në mëngjes dhe mbrëmje", shumica e dijetarëve e konsiderojnë jo të saktë.

Thotë shejh Abani në [Silsiletu es-Sahihah 3245] pasi përmend këtë hadith dhe sjell rrugët e transmetimit të tij:

وهي على كل حال زيادة شاذة

"Kjo shtesë (në mëngjes dhe mbrëmje) është e dobët." -F.

Shumica e dijetarëve këtë shtesë e konsiderojnë të dobët.

Shumë libra të njohur të dhikreve dhe duave, si libri:

-- [Amelul Jeumi uel Lejleh] i Ibn Es-Sunnij, prej librave më të mëdhenj dhe më të mirë në lidhje me dhikret.

-- [Amelul Jeumi uel Lejleh] i Nesaiut.

-- [Edhkeer] i Neueuijut - edhe ky prej librave më të mirë në lidhje me dhikret - nuk e përmendin këtë hadith. Që jep të kuptohet se ndoshta nuk e kanë konsideruar të saktë.

Ibn Es-Sunnij në [Amelul Jeumi uel Lejleh] dhe Neueuiju në [El Edhkeer] e konsiderojnë leximin e Ajetit Kursij prej dhikreve të mëngjesit dhe të mbrëmjes. Por ata për këtë nuk bazohen në këtë hadith, por bazohen në hadithin që përmendëm në fillim:

((Kush lexon {HA MIIM} deri te ajeti {UE ILEJHIL MESIIR} dhe Ajetin Kursij...))

Ama, ky hadith, siç u përmend më lart, konsiderohet i dobët te shumica e dijetarëve.

Pra, më e përafërta është se leximi i Ajetit Kursij nuk është prej dhikreve të mëngjesit dhe mbrëmjes, sepse nuk ka hadith të saktë që e vërteton këtë. Shejh Bin Bazi, Ibn Uthejmini, Feuzani, Salih El Usajmi etj, thonë se nuk ka hadith të saktë që vërteton leximin e Ajetit Kursij në mëngjes dhe mbrëmje.